KOSOVO

FEDERATION INTERNATIONALE CINEMA TELEVISION SPORTIFS

# Festivali i 5-të i Filmit Sportiv Prishtina 2025

## 5th Sport Film Festival "Prishtina 2025"



Datat: 16 & 17 shtator 2025
16 & 17 September 2025
Lokacioni: Kino ABC, Prishtinë

PREMIERE

# Orari/Schedule
# E martë, 16 shtator/Tuesday, 16th of September

**18:00** – Ceremonia hapëse/Opening ceremony

18:20 – **Luani me rrotë nëpër botë/Luani on wheels rolling around the World**

**Autor/Author:** Fatmir Hajzeri, MITROSPORT
**Viti/Year:** 2025
**Kohëzgjatja/Running:** 27:15
**Shteti/Country:** Kosovë
**Sport:** Boça/Boccia

**Përshkrimi**
Dokumentari rrëfen një histori unike: atë të një individi që ndjek një ide dhe hap pas hapi e shndërron atë në një realitet të njohur në nivel ndërkombëtar. Me përkushtim, sakrificë dhe vullnet të pathyeshëm, ai nuk ndalet përballë asnjë sfide. Themelon klube, krijon një ligë, themelon një federatë dhe hap dyert për njohjen ndërkombëtare të sportit të boçës në Kosovë.
Luani me "boçën" u jep zë dhe hapësirë personave me aftësi të kufizuara, duke u mundësuar atyre që, përmes këtij sporti, të ndajnë gëzim, miqësi dhe shpresë në çdo cep të botës.

**Description**
The documentary tells a unique story: that of an individual who pursues an idea and, step by step, transforms it into a reality recognized at the international level. With dedication, sacrifice, and unbreakable willpower, he does not stop in front of any challenge. He founds clubs, creates a league, establishes a federation, and opens the doors to the international recognition of the sport of boccia in Kosovo.
The Lion with the "boça" gives voice and space to people with disabilities, enabling them, through this sport, to share joy, friendship, and hope in every corner of the world.



## E mërkurë , 17 shtator/Wednesday, 17th of September

### 16:30 – Ëndrra për lavdi/Dreaming of Glory

**Autor/Author:** Valdete Osmani
**Viti/Year:** 2025
**Kohëzgjatja/Running:** 41 min
**Shteti/Country:** Kosovë
**Sport:** Te kombinuara/Combined

**Përshkrimi**
"Dreaming of Glory", një rrëfim frymëzues për arritjet e jashtëzakonshme të pjesëtarëve të komuniteteve egjiptian, rom dhe ashkali në sport, kulturë, art dhe jo vetëm. Ky dokumentar sjell histori suksesi, përpjekjesh dhe triumfi ndaj sfidave që ata përballen çdo ditë.

**Description**
"Dreaming of Glory", an inspiring story of the extraordinary achievements of members of the Egyptian, Roma, and Ashkali communities in sports, culture, art, and beyond. This documentary brings forward stories of success, perseverance, and triumph over the challenges they face every day.



### 17:11 – Një shqelm kundër racizmit/Dealing a blow to racism

**Autor/Author:** Besian Beha – Media Group Publico
**Viti/Year:** 2025
**Kohëzgjatja/Running:** 07:25
**Shteti/Country:** Kosovë
**Sport:** Futboll/Football

**Përshkrimi**
Ky dokumentar trajton sulmin fizik ndaj futbollistit 15-vjeçar nga komuniteti Ashkali, Belgin Jashari, i cili u sulmua në fushë nga një prind i ekipit kundërshtar. Ai pasqyron diskriminimin dhe sfidat me të cilat përballet Belgini si pjesë e një komuniteti të margjinalizuar, si dhe mbështetjen që merr nga trajneri dhe shokët e skuadrës. Pas publikimit, sulmuesi u arrestua dhe në Kosovë nisi një fushatë e gjerë kundër racizmit.

**Description**
This documentary tells the story of 15-year-old footballer Belgin Jashari from the Ashkali community, who was attacked on the pitch by a parent of an opposing player. It highlights the discrimination and challenges he faces as part of a marginalized community, as well as the support from his coach and teammates. Following its release, the attacker was arrested and a major anti-racism campaign was launched in Kosovo.

17:20– **Gjuetia e adrenalinës/The hunt of adrenaline**

**Autor/Author:** Ilir Halimi - Mtb Prishtina
**Viti/Year:** 2025
**Kohëzgjatja/Running:** 21 min
**Shteti/Country:** Kosovë
**Sport:** Çiklizëm Malor/Mountain Biking

**Përshkrimi**
Të rinj me ëndrra të mëdha. Një sfidë që bëhet realitet. Gara ndërkombëtare në Gërmi. Miqësi, pasion dhe fitore.

**Description**
Young people with big dreams. A challenge that becomes reality. An international race in Gërmia. Friendship, passion, and victory.

17:41 – **Ajo mal/She's Mountain**

**Autor/Author:** Utalaya Foundation
**Viti/Year:** 2025
**Kohëzgjatja/Running:** 18:18 min
**Shteti/Country:** Kosovë
**Sport:** Bjeshkatari

**Përshkrimi**
Projekti AJO'MAL, i zbatuar nga Fondacioni Utalaya, bashkoi vajza dhe gra nga profesione e rajone të ndryshme të Kosovës, duke i rilidhur ato me malet e vendit. Ky udhëtim unifikues shndërroi traumën kolektive të izolimit dhe frikës në dashuri për natyrën, duke promovuar përfshirjen e grave në sport dhe duke avokuar për barazi gjinore.

**Description**
AJO'MAL project, implemented by the Utalaya Foundation, brought together girls and women from diverse professions and regions of Kosovo, reconnecting them with the country's mountains. This unifying journey transformed the collective trauma of isolation and fear into a love for nature, while promoting women's inclusion in sports and advocating for gender equality.



18:10 – **Rilindur/Rinascere (reborn)**

**Autor/Author:** Umberto Marino
**Viti/Year:** 2022
**Kohëzgjatja/Running:** 100 min
**Shteti/Country:** Kosovë
**Sport:** Not/Swimming

**Përshkrimi**
Rinascere (2022) është një film italian i drejtuar nga Umberto Marino, i frymëzuar nga autobiografia e notarit Manuel Bortuzzo. Ai tregon historinë e vërtetë të atletit të ri, ëndrrat olimpike të të cilit u shkatërruan në vitin 2019 pasi u qëllua aksidentalisht dhe mbeti i paralizuar. I mbështetur nga familja, miqtë dhe mjekët e tij, Manuel nis një udhëtim qëndrueshmërie dhe shprese, i vendosur të "rilindë". Forca e tij përfundimisht e çoi atë të garonte në Lojërat Paralimpike.
***Shfaqja e filmit bëhet e mundur falë bashkëpunimit me Ambasadën Italiane në Kosovë dhe RAI-n, me rastin e edicionit të dytë të "Ditës Botërore të Sportit Italian"**

**Description**
Rinascere (2022) is an Italian movie directed by Umberto Marino, inspired by the autobiography of swimmer Manuel Bortuzzo. It tells the true story of the young athlete whose Olympic dreams were shattered in 2019 after he was accidentally shot and left paralyzed. Supported by his family, friends, and doctors, Manuel embarks on a journey of resilience and hope, determined to "be reborn." His strength eventually led him to compete in the Paralympics.



## 19:30– Kampioni i valëve/Champion of the waves

**Autor/Author:** Burim Haliti & Ganimete Sava
**Viti/Year:** 2025
**Kohëzgjatja/Running:** 02:25 min.
**Shteti/Country:** Kosovë
**Sport:** Not/Swimming

**Përshkrimi**
Gersi Troka është një djalë 15-vjeçar me sindromën Doën. Ai është një notues i talentuar që ka fituar shumë medalje në gara kombëtare dhe ndërkombëtare. Ky dokumentar i shkurtër ndjek udhëtimin e tij drejt njërit nga garat më të rëndësishme të karrierës së tij. Në Berlin, Gersi kapërcen jo vetëm konkurrencën, por edhe paragjykimet shoqërore, duke fituar medaljen e artë. Është një histori frymëzuese për guxim, përkushtim dhe triumf pa kufij.

**Description**

Gersi Troka is a 15-year-old boy with Down syndrome. He is a talented swimmer who has won numerous medals in national and international competitions. This short documentary follows his journey to one of the most important races of his career. In Berlin, Gersi overcomes not only his competitors but also social prejudice, winning the gold medal. It's an inspiring story of courage, dedication, and triumph beyond limits.






## 19:33 – Ia dolëm/We made it

**Autor/Author:** Blerdi Malushi
**Viti/Year:** 2025
**Kohëzgjatja/Running:** 25:14 min.
**Shteti/Country:** Kosovë
**Sport:** Paralimpik/Paralympics

**Përshkrimi**
Ky dokumentar ndjek pjesëmarrjen historike të Kosovës për herë të parë në Lojërat Paralimpike Paris 2024, duke nxjerrë në pah udhëtimin frymëzues të sportistit Grevist Bytyçi. Me vendosmëri dhe qëndrueshmëri, Grevisti e kthen ëndrrën e tij në realitet, duke u bërë simbol shprese dhe përfaqësimi për sportistët me aftësi të kufizuara në Kosovë.

**Description**
This documentary follows Kosovo's historic first participation in the Paralympic Games at Paris 2024, highlighting the inspiring journey of athlete Grevist Bytyçi. Through determination and resilience, Grevist turns his dream into reality, becoming a symbol of hope and representation for athletes with disabilities in Kosovo.

## 20:00 – 4 çerekët/4 quarters

**Autor/Author:** Leart Hoxha
**Viti/Year:** 2025
**Kohëzgjatja/Running:** 49 min
**Shteti/Country:** Kosovë
**Sport:** Basketboll

**Përshkrimi**
Tregime nga dora e parë e akterëve të kohës se si mbijetoi basketbolli i Kosovës në periudhën e shkatërrimit të Jugosllavisë, okupimit dhe diskriminimit për një dekadë dhe si filloi ngritja e pasluftës.

**Description**
Firsthand stories from the key actors of the time about how basketball in Kosovo survived during the period of Yugoslavia's dissolution, occupation, and a decade of discrimination, and how its post-war rise began.




## 20:58 – 10 ditë me atin tim/10 Days with My Father

**Autor/Author:** Ylli Pepo, Fatmir Mneri
**Viti/Year:** 2024-2025
**Kohëzgjatja/Running:** 49 min
**Shteti/Country:** Shqipëri
**Sport:** Futboll

**Përshkrimi**
Është historia e dhimbshme e një prej futbollistëve më të shquar të Shqipërisë, qendërmbrojtësit Skënder Halili, i cili përfundoi në burgjet e regjimit të kaluar, vetëm sepse nuk deshironte të luante me skuadrën e Sigurimit "Dinamo", por me ekipin e tij të zemrës, aty ku ishte rritur, "17 Nëndorin" e Tiranës. Ai vdiq nga hidhërimi, sapo doli nga burgu, në moshën 42 vjeçare, në vitin 1982.

**Description**
This is the painful story of one of Albania's most distinguished footballers, central defender Skënder Halili, who ended up in the prisons of the former regime simply because he refused to play for the Security team "Dinamo," choosing instead his beloved club where he had grown up, "17 Nëntori" of Tirana. He died of grief shortly after being released from prison, at the age of 42, in 1982.

PREJ 1925
BANKA KOMBETARE TREGTARE
100 Vjet

## FOLLOW US!

Kosovo Olympic Committee

kosovoolympiccommittee

kosovoolympiccommittee

Kosovo Olympic Committee

NOC KOSOVO

www.noc-kosovo.org

REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

PREJ 1925
BANKA KOMBETARE TREGTARE
HIB PETROL
gjirafa.com
Hotel SIRIUS
CONFERENCE CENTER
KOSOVAPRESS